



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:087182

Datë: 08.11.2021

Numri i dokumentit: 02408426

C.nr.1213/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit F.R. nga fshati ... Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim av Fitim Shabani nga Ferizaj, kundër të paditurave Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), të cilin e përfaqëson me autorizim Leonora Rrecaj dhe K.S.Elsig me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Veton Bublaku, në çështjen për kompensimin e dëmit, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 18.10.2021, në prezencën e të autorizuarit të paditësit, dhe të përfaqësuesit të paditurit mori, ndërsa me datë 8 nëntor 2021 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.R. nga fshati ... Komuna Ferizaj dhe **DETYROHEN** të paditurat Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) dhe K.S.Elsig me seli në Prishtinë që paditësit të ia kompensojë dëmin në shumën prej 11.250€ shumë e cila do të ndahet 50% - 30 % mes të paditurave, dhe atë :

a)Dëmin jo material:

Për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën për 3% shumën prej 3,500 €;

Për dhimbje trupore –fizike shumën prej 2,500 €;

Për frikën e shkaktuar shumën prej 2,000 €;

Për shëmtim trupor shumën prej 2,000€;

b)Dëmin material:

Për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej 475 €;

Për ushqimin e përforcuar shumën prej 475 €;

Për rehabilitim klimaterik shumën prej 300 €;

II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e miratuara në lartësi prej 5,000€.

III. DETYROHEN të paditurat që paditësit t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I. të këtij dispozitivi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,488.06 €, të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 8% në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

IV. DETYROHET paditësi që të paguajë shumën prej 80 € në emër të taksës për padi në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi

A r s y e t i m

Paditësi nëpërmjet të të autorizuarit të tij Av. Fitim Shabani, ka paraqitur padi në gjykatë më dt.22.07.2020, për kompensimin e dëmit material dhe jo material për shkak të aksidentit të shkaktuar me dt. 03.06.2021 rreth orës 19:00, nga vozitësi i automjetit të markës Wollsfagen Caddy, me ngjyrë të bardhë dhe me targa të regjistrimit ... dhe pa sigurim valid. Deri tek aksidenti rrugor ka ardhur atëherë kur Nj-“A”, të cilën e drejtonte Xh.V. duke qarkulluar prej drejtimit të Ferizaj në drejtim të Kaçanikut me të arritur në kryqëzimin fshatin Gërlit K.Ferizaj njësia A në dy vija të plota e fillon çkyqjen nga rruga në anën e majtë në drejtim të Vitisë pa u siguruar mirë se mund ti rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe në atë moment prej drejtimit të kundërt Kaçanik-Ferizaj vijë njësia B me një shpejtësi të madhe duke mos e përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës në kryqëzim dhe njësia një A me pjesën e parë të anës së majtë e goditet njësinë dy B në anën e majtë, në rrotën e dytë dhe pas goditjes njësia dy sillet e del jashtë rrugës në anën e djathtë të lëvizjes drejtimi i Ferizaj, e godet në anën e djathtë njësinë tre në parking, i godet këmbësorët të cilët ishin duke shitur në tezga pemë jashtë rrugës. Me këtë rast në tri automjetet është shkaktuar dëm material dhe lëndime trupore kanë marrë njësinë dy vozitësin A.G., pasagjerin L.S. dhe këmbësoret F.R., P.S. dhe L.A. të cilët pas aksidentit janë dërguar në Emergjencën në Ferizaj, ku pas ndihmës së parë paditësi F.R. është dërguar në QKUK- Prishtinë.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 30.04.2021 ka bërë zgjerimi ne padisë në kuptimin subjektiv duke propozuar që si e paditur e dytë të përfshihet edhe KS''Elsig'' me seli në Prishtinë, pasi pas ekspertizës së komunikacionit është vërtetuar se lëshime në aksidentin e

shkaktuar kanë 2 njësit , gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ka theksuar se në provat e nxjerra gjatë kësaj procedure e posaçërisht nga mendimi i ekspertëve mjekësor, i propozon gjykatës që në kuptim të nenit 147 të LPK-së të bijë aktgjykim të pjesshëm, në atë mënyre që të miratohen shumat e paraqitura në kërkesë padi. Konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për tu sjell një aktgjykim i tillë ngase nga konstatimet e ekspertëve mjekësor është konstatuar se paditësi ka natyrë të pasojave psikike në atë shkallë që tani për tani shprehet me pasojat si në ekspertizë, ku të njëjtat paraqesin lëndime të shumëfishta trupore, tronditje trunore, ndrydhje koke, ndrydhje qafe, plagë prerëse-shkyese në kokë, ku këto lëndime janë shkaktuar nga rënia, goditja në sipërfaqe të fortë si pasoj e aksidentit ku të njëjtat bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore ku i njëjti ka pasur frik, dhimbje, shëmtim trupor të shkallës së mesme, zvogëlim të përgjithshëm të aktivitetit jetësor, ka pasur nevojë për kujdese të personit të tretë, ushqim të përforcuar, rehabilitim fiziatriko-psikik. Gjithashtu mbesin pranë pajtueshmërisë sa i përket ndarjes së përgjegjësisë 70-30 ku janë pajtuar sipas procesverbalit të datës 10.08.2021, kështu që i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar. Kërkon shpenzimet e procedurës të cekura si në precizimit të kërkesë padisë.

E paditura e parë BKS përmes të autorizuarit të saj si në përgjigje në padi ashtu edhe në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshtojnë precizimin e kërkesë padisë si tejet të lartë dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore, po ashtu sa i përket dëmit material kjo kategori e njëjtë nuk është argumentuar me prova përkatëse gjegjësisht me kupona fiskal të cilët do të vërtetonin shumën e kërkuar si në precizim. Në përgjigje në padi e paditura ka deklaruar se me qëllim të ekonomizimit të procedurës i ofron të paditurit shumën prej 2.000€ për dëmin material dhe jo material. I propozojnë gjykatës që përtej shumës së ofruar kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës i propozon që gjykata të vendos konform nenit 452 pika 2 të LPK-së.

E paditura e dytë K.S Elsig përmes të autorizuarit të saj si në përgjigje në padi ashtu edhe në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin pranë dakordimit me të paditurën e pare lidhur me ndarjen e përgjegjësisë dhe atë në raportin 70-30, ndërsa sa i përket precizimit të kërkesëpadisë shumat e kërkuara për dëmin material janë në shpërputhje me lëndimet e pësuar të paditësit dhe në kundërshtim me nenin 183 pika 2 të LMD-se dhe janë në kundërshtim me praktikën gjyqësore përkatësisht me Gjykatën e Apelit

dhe Gjykatën Supreme, sa i përket dëmit material kërkojnë nga gjykata që të aprovoj shumat të cilat janë të argumentuara me faturat apo kuponat fiskal. Përtej shumës së ofruar në seancën e datës 10.08.2021 nga dy të paditurat pjesën tjetër të kërkesëpadiisë së paditësit ta refuzoj si të pa bazuar pasi që shumat e kërkuar në precizim janë tejet të larta dhe nuk janë në proporcion me lëndimet e pësuar tek paditësi në të kundërtën ta refuzoj në tërësi kërkesëpadiinë e paditësit sa i përket dëmit material. Sa i përket kamatës kërkojnë nga gjykata që e njëjta të filloj të rrjedh nga dita e aktgjykimit dhe jo nga data e paraqitjes së padisë, pasi që si e paditur e dytë janë njoftuar për këtë dëm me datën 29.06.2021.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqëse administroi këto prova, dhe atë raporti policor me numër 2020-CFT-189 date 03.06.2020, skica e vendit të ngjarjes, raporte mjekësore në emër të paditësit, kupona fiskal, ekspertiza e komunikacionit date 27.04.2021, përgjigja në padi datë 02.12.2021, parashtrese e datës 30.04.2021, përgjigje në padi e datës 09.07.2021, ekspertiza mjekësore e datës 20.09.2021, parashtrese për precizimin e kërkesëpadiisë datë 18.10.2021.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lire të gjykatës, Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më dt.03.06.2020 ky aksident është shkaktuar me fajin e vozitësit të automjetit Wollsfagen Caddy me targa të regjistrimit ..., me ç'rast lëndime të rënda trupore ka pësuar paditësi F.R., si rezultat i këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë dhe ka pasur nevojë për rehabilitim klimaterik ushqim të përforcuar si dhe shpenzime gjatë shërimit gjithashtu ka pasur edhe shëmtim trupor dhe zvogëlim të përgjithshëm të aktivitetit jetësor, dhe se përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të tilla janë të paditurat, fakte këto të cilat sipas nen.173 dhe 183 të LMD-së paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

Se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën dt.03.06.2020, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga raporti i aksidentit 2020-CFT-189 date 03.06.2020 e fakt ky i cili nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

Se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me fajin e vozitësit të automjetit Wollsfagen Caddy me targa ... dhe po ashtu ky automjet ishte i siguruar tek e paditura, këto fakte gjykata i vërtetoi nga raporti i aksidentit 2020-CFT-189 date 03.06.2020, si dhe lëshime sekondare ka edhe shoferi i automjetit B (Citroen) me targa ..., e po ashtu ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

Se nga kush është shkaktuar aksidenti gjykata e ka vërtetuar edhe në bazë të mendimit të ekspertit të komunikacionit B.L. më datë 27.04.2021, si dhe në seancë ka deklaruar se ka konstatuar se duke i analizuar të gjitha shkresat e lëndës lëshime kryesore në shkaktimin e këtij aksidenti ka shoferi i automjetit “A” i markës Wolkswagen- Caddy me targa ... me veprimet e tij : Ç kyqje e palejuar dhe e pasigurte nga rruga kryesore; mos respektim i përparësisë së kalimit ndaj automjetit “B”; lëshime sekondare në këtë aksident ka edhe shoferi i automjetit “B” (Citroen) me targa ... i cili ka lëvizur me shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar për atë pjesë të rrugës. Padiësi në momentin e ndodhjes së aksidenti ka qenë në cilësi të këmbësorit jashtë rruge dhe i njëjti nuk ka lëshime në këtë aksident.

Se padiësi ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja në aksident, kjo është jo kontestuese për gjykatën sepse u vërtetua me provat e nxjerra nga ekspertët mjekësor Dr.M.H. ortoped më dt. 20.09.2010, Dr. N.M. Psikiatër e dt. 20.09.2021.

Se padiësit ka pësuar lëndim të rënda trupore këtë e vërtetoi nga ekspertiza e Dr. M.H.- ortoped i cili ka konstatuar se padiësi ka lëndime të rënda dhe atë (tronditje trunore, ndrydhje koke, ndrydhje qafe, plagë prerëse- shkyese në kokë); padiësi nga lëndimet e lartcekura të specifikuara si me lart ka pësuar dhimbje fizike- trupore dhe atë: të intensitetit posaçërisht të lartë disa sekonda deri në humbje të vetëdijes; të intensitetit të lartë – 3 dite; të intensitetit të mesëm – 30 dite, si dhe të intensitetit të ulët ekzistojnë edhe sot e kësaj dite.

Shëmtimi trupor është në shkallë të mesme- si pasojë e vragës me gjatësi 12cm dhe gjerësi 0.5cm në pjesën e pasme të kokës në formë drejtëvizore e dukshme pjesën më të madhe të kokës pasi që padiësi mban flokë të qethura ulët, e cila e vë në pozitë të pa pëlqyeshme dhe jo të përshtatshme, në dhënien e mendimit ka marrur parasysh edhe moshën e re të padiësit, dhe për këtë arsye i aprovoi shumat si në dispozitiv nr.I të këtij aktgjykimi.

Se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë në kohëzgjatje prej 35 dite pasi që ka qenë i detyruar të qëndroje në pozicionin i shtrirë në shtrat edhe i është ofruar ndihma në veshmbathje dhe higjiene personale, kryerja e nevojave të rregullt fiziologjike, andaj gjykatë vendosi që të caktoj shumën si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se është në proporcion real me nevojat e paditësit.

Paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 35 ditësh, ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksione post traumatike, andaj gjykatë vendosi që të caktoj shumën si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se është në proporcion real me nevojat e paditësit.

Paditësi ka pasur nevojë për rehabilitim fiziatriko-psikik në kohëzgjatje prej 15 ditësh i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyjet të boshtit kurrizor si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e shtangimit të zhvilluar në nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjes në kohën e shërimit, andaj gjykatë vendosi që të caktoj shumën si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se është në proporcion real me nevojat e paditësit.

Se paditësi në këtë aksident ka përjetuar frikë, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. N.M. – Psikiatër në ekspertizën e bërë me datë 20.09.2021, i cili ka ardhur në përfundim se paditësi përpos që ka pësuar –përjetuar dhimbje trupore –fizike gjithashtu ka përjetuar edhe frikë dhe atë : frikë primare në momentin e aksidentit nuk është evidentuar sepse paditësit nuk i kujtohet asgjë në atë moment për shkak të humbjes së vetëdijes.

-frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 3 ditë, shoqëruar me stres intensiv, pagjumësi, vështirësi të adaptimit me kushtet e trajnimit mjekësor, nervozë, shpërthime emocionale; frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur 1muaj e shfaqur me ankthe, pagjumësi gjatë natës, rikujtime të ngjarjes traumatike, vështirësi të adaptimit me kushtet e imoblizimit dhe trajtimit mjekësor me qafore, mungesë e vëmendjes dhe koncentrimin, indisponim; frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur edhe për 12 muaj vijues e shfaqur me ankthe, stres të moderuar, çrregullime të gjumit, breng për ecurinë e mjekimit, mungesë motivi dhe disponimi, andaj gjykatë vendosi që të caktoj shumën si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se është në proporcion real me nevojat e paditësit.

Se në këtë aksident paditësi ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm i cili është në shkallën 5% (pesë përqind), që është si pasoj e tronditjes trunore e verifikuar në kushte spitalore brenda 24 orëve, duke e krahasuar me gjendjen e shëndoshë dhe ku edhe pas mjekimit dhe rehabilitimit konsiston në pamundësinë e paditësit që ti kryej aktivitetet e mëparshme, ti plotësoj nevojat dhe dëshirat e tij, gjykata e vërtetoi nga mendimi i Ekspertëve të dhënë në ekspertizën e dt.20.09.2021 andaj gjykata vendosi që të caktoj shumën prej 11,250 € duke konsideruar se është në proporcion real me nevojat e paditësit.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e miratuar në lartësi prej 5,000 € pasi që shumat e kërkuara si në precizimin e kërkesëpadisë ishin shuma tepër të larta e të cilat nuk përkojnë me asnjë praktikë gjyqësore dhe nuk janë në harmoni me kriteret e kompanive të sigurimit këtë konkluzion gjykata e bazoi duke marr parasysh llojin e lëndimit të paditësit, dhimbjet e përjetuara si dhe pasojat tjera të aksidentit, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të mjekësisë si dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri, e duke u bazuar në nen.323 të LPK-së, në vlerësimin e lire ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e theksuar nga paditësi për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike.

Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarit të paditësit, i cili i propozoj gjykatës që ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se shumat e kërkuara si në precizim të kërkesëpadisë janë në harmoni me kriteret të cilat aplikohen nga kompanitë e sigurimit dhe praktika gjyqësore, sepse paditësi ka pësuar lëndime trupore pa fajin e tij, përgjegjëse për të cilën janë të paditurat 70-30 %, dhe të paditurat kanë obligim të përmbushjes së detyrimeve dhe po ashtu shtoi se kërkesëpadia është në përputhje të plotë me dispozitat e LMD-së dhe se si e tillë duhet të miratohet në tërësi, e këtyre theksimeve gjykata pjesërisht ua dha besimin e plotë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarave të paditurave, të cilat i propozojnë gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta aprovojë pjesërisht pasi që precizimi i kërkesëpadisë është mjaft i lartë, këto theksime gjykata pjesërisht i morri si të bazuara të cilat kishin të bënin lidhur me lartësinë e shumës së kompenzimit, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u theksua më lart u vërtetua se paditësi si pasojë e lëndimeve të shkaktuara në aksidentin e cekur më lart, ka pësuar dëm material dhe jo material në shumat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, nga baza e auto përgjegjësiive respektivisht në mbështetje të nenit 19 të LSDA-së, si dhe duke u bazuar në nenin 136, nenit 173 par.1, 179 dhe neni 183 të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën, meqenëse të paditurat kanë rënë në vonesë për kompensimin e dëmit paditësi, Gjykata në bazë të nenit 382 të LMD-së dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 265/2020 të datës 02.12.2020 bazuar në pjesën e dytë pika VI, ka vendosur që lartësia e kamatës të jetë 8%, ndërsa sa i përket llogaritjes së saj, nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi deri në pagesën definitive, është vendosur po ashtu bazuar po në këtë Mendim Juridik bazuar në Pjesën e Tretë pika XIV.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.488.06€ edhe atë: 208€ për përpilimin e padisë, për dy seanca të mbajtura për secilën veç e veç shumë prej 270.20€ gjithsej 540.04€, për ekspertizat 450€(ekspertiza e psikiatrisë, ekspertiza e ortopedisë di dhe ekspertiza e komunikacionit) si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 20€, ndërsa obligoi paditësin të paguaj për taksë gjyqësore 80 € pasi vlera e kontestit është mbi 10,000 €, gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.1213/20 prej dt.8 nëntor 2021

Gjyqtarja
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë përmes, kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.